

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: SPITALI I PËRGJITHSHËM "DR.SAMI HAXHIBEQIRI" - MITROVICË

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	220/70040-26-5219-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Furnizimi meqarshafa, mysheme, batanije, jastek etc per nevoja spitalore te pacienteve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Agron Commerce SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Zona Industriale pn

(Adresa)

Mitrovicë

40 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 49490500

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Elmar Syla

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eurotexks@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Pri: tinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 01.07.2026

Hapja e ofertave: 13.07.2026

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 17.07.2026

Kërkesë për rishqyrtim: 21.07.2026

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 24.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Bashkangjitur gjeni vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 70 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt.17.07.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE Kiga SHPK me çmim prej:18,917.18 €, ndërsa ne jemi shpallur tenderues i pasuksesshëm, ndërsa kemi ofertuar me çmim prej 19,893.03€.

Me datën 17.07.2026 kemi kërkuar qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa qasja na është lejuar me dt.20.07.2026, e ku kemi vërejt se oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka mangësi substanciale dhe shumë të mëdha e të cilat e bëjnë të papërgjegjshëm këtë ofertë.

Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së ëshët kërkuar:

2.Mostrat.

Dëshmi e kërkuar dokumentare

2.OE duhet të dorzojë nga një moster për secilën pozicione që janë në DT . Mostrat duhet të jenë në paketimin origjinal të prodhuesit. Mostrat duhet të kenë teketat me të gjitha përshkrimet teknike të produktit. Mostrat duhet dorzuar në zyrën e prokurimit para hapjes së ofertave.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar mostrat por nuk i ka ofruar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe përshkrimit të specifikave tek përshkrimi i çmimit.


- Batanija dhe peshqiri janë ofertuar me dimensione të ndryshme nga ato të kërkuara,

qarshafat dhe kompresat nuk janë rezistente ndaj ujit dhe gjakut, artikulli "Mysheme" nuk e ka pjesën shtesë prej 15 cm dhe patenti nuk është i vendosur sipas specifikimeve, ndërsa mostrat nuk kanë qenë të etiketuara dhe të identifikuara sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Shih më poshtë paketimi i mostrave nuk përmban asnjë identifikim dhe titull të aktivitetit të prokurimit.




Ne paketimin e mostrave mungon identifikimi I OE dhe aktivitetit te prokurimit



Mungojnë etiketat me te gjitha pershkrimet teknike te produktit(ne te gjitha artikujt)

Pra, mostrat nuk kanë pasur tiketat siç është kërkuar në dosje të tenderit-tek përshkrimi i çmimeve, prandaj kjo mangësi e bënë të papërgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Shih më poshtë fotot e myshemes me mangësitë e cekura.



Kërkesa e AK-se:

Mysheme -Dimensioni 220cm x 90cm x 15 cm (mungon pjesa shtesë prej 15 cm)


Ngjyra gjelbert ose e kalter (ngjyra nuk është siç është kërkuar)

Hapjen me patent për se gjati dhe te jete me patent cilesore (patenti nuk është i vendosur sipas kërkesës)


Kërkesa tek përshkrimi i çmimit ka qenë si më poshtë:

Mysheme -Dimensioni 220cm x 90cm x 15 cm Materiali i myshemes eshte 100% polyester , qe eshte rezistent ndaj ujrave dhe njollave Ngjyra gjelbert ose e kaltert Te kete tiketen e permbajtjes se materialit dhe perdorimit Te jene me logo te Spitalit Forma e myshemes te jete qe te futet I gjithe dysheku I shtratit ne mysheme , si dhe te kete hapjen me patent per se gjati dhe te jete me patent cilesore Te jete sipas standarteve ISO 105 C06 2010 , ISO 105 X12 2001 , ISO 105 E04 2013 , ISO 105 B07 2009 Atesti i materialit obligative Mostra obligative sipas specifikave


- Dimensionet e mostrave nuk janë ofruar sipas kërkesës dhe përshkrimit të specifikimeve, shih më poshtë argumentet me foto:




Dimensioni I peshqirit eshte e kekruar 45 X 85 cm - kurse mostra eshte 50 X 100 cm



Kerkesa e AK-se:
Kompresa te gjelberta pa vrime per sallat operative -Dimensioni I kompresave te jete 150cm x 150cm
(Gjatesia me e madhe se 150cm)



Kerkesa e AK-se:
Dimensioi i qarshafit dhe postaves 130 cm x 210cm
(Mostra e prezentuar ka keto dimensione: 137 cm x 236 cm)



Kerkesa e AK-se:Qarshafa te kaltert me nuance te hapur per sallat e lindjes
Dimensioi i qarshafave 200cm x 250cm
(Mostra e prezentuar ka keto dimensione: 240 cm x 250 cm)



Qarshafa te gjelbërta pa vrimë për sala operative
Materiali nuk është 100% poliester siç është kërkuar në dosjen e tenderit,
dhe nuk është rezistent ndaj ujit dhe gjakut



Kërkesa e AK-se:
Batanije për pacient -Dimensioni i batanijes 150cm x 200cm (Dimensioni nuk është sipas kërkesës)

Siç shihet nga fotot e renditura më lartë, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar mostra sipas specifikave teknike dhe dimensioneve të kërkuara, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca automatikisht.

Tek secili produkt, tek përshkrimi i specifikave është çekur mostra obligative sipas specifikave, prandaj mostrat është dashur të ofrohen me specifika siç është kërkuar, ndërsa nëse nuk ofrohen atëherë oferta e tillë konsiderohet e papërgjegjshme dhe është dashur të eliminohet.

Sipas nenit 37.6 të RRPP Nr.001/2022 “Mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë të testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender”.

Mbi këtë bazë kur mostra nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit atëherë OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

- OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar edhe kërkesën e nenit 9.1&9.2 të FDT-së ku është kërkuar:

1.OE duhet të ketë realizuar minimum 3 kontrata të natyrës së ngjajshme për 3 vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Kontrat duhet të në vlerë financiare jo më pak se 25.000,00 euro.

1.listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara apo shërbimet, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi apo shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimi ose shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi ose shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i liferimit ose shërbimit të tillë

Në lidhje me këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave si më poshtë:

KIGA SHPK - LISTA E KONTRATAVE						
Nr.	Nr.i prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Autoriteti Kontraktues	Titulli i Kontrates	Vlera e Kontrates
1	220-70900-23-1944-1-2-1	14.04.2023	13.04.2025	QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE	Lot 1. Furnizimi me Letër për Duar	€ 15,999.62
2	220-70900-23-1944-1-2-1	14.04.2023	13.04.2025	QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE	Lot 2. Furnizim me material higjenik	€ 13,800.69
3	220-70001-0731-23-5330-	04.07.2023	03.07.2025	SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN	Furnizim me material të ndryshëm Hixhenik	€ 50,000.00
4	70040-23-1201-1-2-1	03.04.2023	02.04.2025	SPITALI I PËRGJITHSHËM "DR.SAMI HAXH	Furnizimi me material higjenik	€ 90,000.00
5	612-23-2688-1-2-1	05.05.2023	05.05.2024	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË	Furnizim me material higjenik	€ 64,971.20
6	220-23-6290-2-2-1	04.08.2023	04.08.2024	SPITALI FERIZAJ	Pastrimi i hapësirave të brendshme dhe të jasht	€ 98,000.00
7	711-23-6567-1-2-1	27.07.2023	27.07.2025	I.K. Shëndetësisë Publike të Kosovës	Furnizim me produkte për mbajtjen e higjienës,	€ 37,240.00
8	70020-24-12506-1-2-1	26.12.2024	25.12.2025	SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË	Furnizim me material higjenik	€ 40,000.00
9	659-24-1717-1-3-6	03.04.2024	02.04.2025	KOMUNA HANI I ELEZIT	Furnizim me material higjenik për nevoja të inst	€ 7,951.95
10	642-23-5090-1-2-1	10.07.2023	09.07.2026	KUVENDI KOMUNAL MITROVICË	Furnizim me material Higjenik për mirembajtje	€ 120,000.00
11	614-26-963-1-2-1	14.05.2026	13.06.2026	KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ	Furnizim me material Higjenike për Institucione	€ 15,555.50
12	71201-24-9201-1-2-1	14.10.2024	13.03.2025	QENDRA E SHËNDETIT MENDOR-PRISH	Furnizim me Mobilje (shtreter,ormana,kuzhinë	€ 14,993.04
13	70020-25-10373-1-2-1	05.01.2026	04.06.2026	SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË	Ri-tender II Furnizim me mbulesa dhe batanije	€ 14,760.00
14	211-24-10042-1-2-1	08.11.2024	07.11.2025	MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM	Furnizim me teknikë të bardhë për pjesëtarët e	€ 55,555.50
15	71201-25-5480-1-3-6	14.07.2025	13.10.2025	QENDRA E SHËNDETIT MENDOR-PRISH	Furnizim me veshmbathje për Shtëpinë Integruar	€ 3,999.00
16	615-23-1754-1-1-1	21.06.2023	05.08.2023	KOMUNA E PODUJEVËS	Furnizim me pajisje mjeksore	€ 26,540.00
						€ 669,366.50



Prej 16 kontratave të listuara në këtë listë, vetëm kontrata me numër rendor 13 dhe 15 janë kontrata të ngjashme sipas kërkesës së lartcekur, mirëpo të dy këto kontrata arrijnë vlerën 18,759.00 €. Të gjitha kontrata tjera nuk kanë të bëjnë fare me natyrën e këtij tenderi e as nuk janë të ngjashme me këtë tender, prandaj nuk mund të merren parasysh kontratat e tjera.

- OE nuk ka dorëzuar certifikatën obligative OEKO-TEX, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë certifikatë apo dokument tjetër që dëshmon se produktet përmbushin standardet ISO 105 C06:2010, ISO 105 X12:2001, ISO 105 E04:2013 dhe ISO 105 B07:2009, megjithëse këto standarde janë kërkuar në specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit.

Tek përshkrimi i specifikave tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës është cekur decidivisht **CERTIFIKATA OEKOTEX E OBLIGUESHME, prandaj mungesa e këtyre certifikatave e bënë të papërgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.**

- OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar as deklaratën për afat të liferimit.

Kur kem parasysh të gjitha këto mangësi substanciale të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se nuk është respektuar neni 59 i LPP-së, pasi që tek paragrafi 4 ceket qartë se për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm duhet të ketë plotësisht në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe ët njoftimit për kontratë, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhshmëri me këto kërkesa, prandaj ky OE është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.24.07.2026 me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar, mirëpo ky vendim nuk i trajton në mënyrë konkrete pretendimet tona ankimore dhe nuk i kundërshton me prova pretendimet e paraqitura nga ne.

- Në lidhje me pretendimin tonë ankimor përkitazi me faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën në lidhje me vlerën e kontratave të ngjashme, autoriteti kontraktues ka pretenduar se edhe kontrata me numër rendor 12 është e ngjashme me natyrën e kontratës.

Pra, autoriteti kontraktues sikurse ne, i eliminon të gjitha kontratat tjera me përjashtim të kontratës me numër rendor 12. Ne e kemi dëshmuar se vetëm kontrata me numër rendor 13 dhe 15 janë të ngjashme, ndërsa AK-së pretendon se edhe kontrata me numër rendor 12 është e ngjashme, mirëpo ky konstatim i AK-së është i pa bazuar dhe në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit.

Kontrata me numër rendor 12 ka të bëjë me furnizim me mobile (shtretër, ormana, kuzhinë),

prandaj nuk ka të bëjë fare me ngjashmërinë e këtij projekti sepse ormanat, kuzhina e shtretërit nuk bëjnë pjesë tek furnizimet me tekstil, qarshafa, myshme, batanije etj por janë furnizime krejtësisht të ndryshme që kanë të bëjnë me elemente të drurit, sanitarisë dhe mobile, prandaj nuk mund të konsiderohen të ngjashme.

- Sa i përket pretendimit tonë për mos përmbushje të specifikave teknike nga OE i rekomanduar për kontratë, AK-së ka konstatuar se pretendimet e operatorit ankues janë vetëm deklarative dhe nuk mbështeten me ekspertizë teknike apo prova objektive, mirëpo ky konstatim nuk është i saktë e as i drejtë sepse ne e kemi dëshmuar me fakte konkrete pretendimin tonë ankimor.

- Sa i përket pretendimit tonë ankimor se paketimi i mostrave nuk përmban emër e as titull të projektit e asnjë identifikim (kod), AK-së është përgjigjur se fleta e të dhënave është larguar nga pakoja për tu marr shënimet për ti vendosur në procesverbal prandaj pretendimi për identifikim të OE nuk qëndron.

Ky konstatim i AK-së është jo profesional dhe i pa argumentuar, pasi që fleta me të dhëna (apo ndonjë identifikim) po të ishte në paketim atëherë ne do ta kishim vërejtur gjatë qasjes në dokumente, apo nëse do të ishte hequr fillimisht për të shënuar të dhënat atëherë përse nuk është kthyer përsëri në vend, mirëpo ky arsyetim është vetëm për të favorizuar OE e rekomanduar për kontratë. Realisht kur shënohen të dhënat atëherë nuk ka të drejtë autoriteti kontraktues ti heq ato të dhëna nga paketa pa e vendosur një kod, kurse të dhënat kanë mundur shumë lehtë të lexohen dhe të vendosen në procesverbal pa u hequr tiketa identifikuese, prandaj arsyetimi i AK-së është jo bindës dhe i pa argumentuar.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që të analizojnë në detaje pretendimet tona ankimore dhe dëshmitë e bashkangjitura me ankesë dhe pastaj të nxjerret një vendim meritore në lidhje me pretendimet tona.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësores të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”,* mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ne edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të

fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. APROVOHET, e bazuar ankesa e OE Agron Commerce SH.P.K.

II. ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.